



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

VENDIM

Nr. 20, Datë 22.02.2012

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- Znj. Anila Jani Kryetare
- Z. Gerdjan Xhanari Nënkryetar
- Znj. Marsida Xhaferllari Anëtare
- Z. Zamir Mocka (Stefani) Anëtar
- Z. Altin Goxhaj Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.02.2012, vazhdoi shqyrtimin e ankesës se ardhur nga Esmeralda Elezaj, ish-studente e Universitetit Jo Publik “Vitrina”. Problematika e ngritur nga kjo ankese konsistonte ne, detyrimin e pagesës prej 500 euro ne këmbim te marrjes se cregjistrimit nga ky Universitet, si dhe një shume te konsiderueshme parash për te marre listën e programeve, vërtetim te notave, etj. Esmeralda Elezaj, bashkëlidhur ankesës ka paraqitur edhe mandat pagesat përkatëse si dhe kontratën me këtë universitet.

Komisioni pas shqyrtimit të ankesës se sipërpërmendur,

VËREN SE:

Shqyrtimi i kësaj ankese ka filluar ne mbledhjen e datës 7.11.2011 dhe, për një vlerësim te plote te kësaj çështjeje, Komisioni i ka kërkuar Universitetit Vitrina informacion ne lidhje me problematiken e ngritur, nëpërmjet shkresës me date 14.11.2011, nr.prot31/1, dhe ritheksuar përsëri me shkresën e datës 25.01.2012, nëpërmjet te së cilës, Universiteti Jo Publik “Vitrina”, është ftuar edhe ne seancën dëgjimore e datës 27.01.2012. Ne seancën dëgjimore te datës 27.01.2012, përfaqësuesja ligjore e Universitetit Vitrina deklaroi se nuk është e autorizuar te japë sqarime apo informacione dhe kërkon me tepër kohe për t’u përgatitur.

Komisioni, me shkresë nr. prot 42/2, date 30.01.2012, i bën me dije marrjen e Vendimit nr.18, date 27.01.2012, nëpërmjet te cilit, Universiteti “Vitrina”, gjobitet me shumën prej 300,000 leke për mosdhënie informacioni, si dhe i kërkohet lista e studenteve qe janë cregjistruar për vitin akademik 2010-2011 gjithashtu, një kopje te kontratës tip te Universitetit me studentet.

Kontrata origjinale, ndërmjet Universitetit Jo Publik “Vitrina” dhe ish-studentes Esmeralda Elezaj, nuk parashikonte, në asnjë nen apo pike te saj, kushtin e pagesës prej 500 euro ne rast

te një kërkesë për çregjistrim nga ky Universitet, apo pagesa për marrjen e listës së programeve, vërtetim notash etj.

Ne baze të ligjit 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar, nenit 33/1 “Përputhshmëria kontraktuale e shërbimeve”:

“Tregtari i ofron konsumatorit shërbime në përputhje me kushtet e kontratës. Tregtari është përgjegjës për mospërputhjet e shërbimit të siguruar konsumatorit me kushtet e kontratës”

Ne këto kushte, detyrimi i pagesës së shumës prej 500 euro në këmbim të marrjes së çregjistrimit, është praktike në kundërshtim me dispozitën e lart cituar. Kjo praktike ka shkaktuar dem tek ankimuesja Esmeralda Elezaj, që përveç pagesës së kësaj shume, i janë kërkuar shuma të tjera në euro për marrjen e listës së programeve shume e cila nuk ka qene e përballeshme nga ankimuesja dhe i ka shkaktuar asaj pamundësi regjistrimi në një universitet tjetër.

Sipas pikës 5 të nenit 57 të ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve, përcaktohet se:

“Kur komisioni në shqyrtimin e kundërvajtjes administrative konstaton shkaktim dem, si pasojë e kundërvajtjes administrative, pas përfundimit të shqyrtimit administrativ, vlerëson masën e demit dhe me një vendim të veçantë vendos për shpërblimin e demit.

Masa e shpërblimit si dhe pagesa për vlerësimin e demit i ngarkohen subjektit që ka kryer kundërvajtjen administrative”

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve mbështetur në nenin 33/1; pika 5 e nenit 57, të Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “b”, pika 6 të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008 “Për mënyrën e funksionimit e të pagesës së anëtarëve të komisionit të mbrojtjes së konsumatorëve, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve” .

VENDOSI:

1. Universiteti Vitrina, të dëmshpërblejë Esmeralda Elezaj me shumën prej 500 euro.
2. Universiteti Vitrina t’i sigurojë, pa pagesë studentes, të gjithë dokumentet e nevojshme për regjistrimin e saj në një universitet tjetër.
3. Universiteti Vitrina, të njoftojë menjëherë Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorëve për dëmshpërblimin e studentes Esmeralda Elezaj, brenda 15 ditësh nga marrja e njoftimit të këtij Vendimi.

Kundër Vendimit të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit keni të drejtë të ankoheni në Gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit.

KRYETARI I KOMISIONIT

